



Federata e Hendbollit e Kosovës
Kosova Handball Federation
Rukometni Savez Kosova

RREGULLORE MBI ORGANIZIMIN E GARAVE TË HENDBOLLIT TË KOSOVËS

Në mbështetje të nenit 7 të Statutit të Federatës së Hendbollit të Kosovës, Bordi i FHK-së në mbledhjen e vet të mbajtur më 1.03.2004, miratoi këtë:

RREGULLORE MBI ORGANIZIMIN E GARAVE TË HENDBOLLIT TË KOSOVËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1

Me Rregullorën mbi garat e hendbollit(në tekstin e e mëtejme Rregullore) të Kosovës, përcaktohen dispozitat themelore mbi sistemin e e përherëshëm të garave dhe kushtet e përgjithëshme të garave tjera në sportin e hendbollit.

Me garat e përherëshme në kuptim të kësaj Rregulloreje nënkuptohen të gjitha garat në konkurrencën e meshkujve dhe femrave edhe ato në kampionatet e Kosovës për të gjitha grup-moshat dhe kupën e Kosovës, të cilat organizohen dhe zhvillohen për çdo vit.

Neni 2

Të gjitha ndeshjet e hendbollit zhvillohen në pajtim dhe përputhje me Rregullat ndërkombëtare të lojës së hendbollit , si dhe sqarimeve dhe komentimeve të cilat i bëjnë Këshillat profesionale dhe Bordi i FHK-së.

Për garat e grup-moshave të reja, kohëzgjatja e lojës mund të jetë me shkurtër por në përputhje me Rregullorën e lojës dhe të IHF-it, ndërsa për ndeshjet e turneve solemne dhe përkujtimore, me Propozicione mund të shkurtohet kohëzgjatja.

Neni 3

Bordi i FHK-së i përcakton dhe i siguron të gjitha kushtet për organizimin e të gjitha garave të përherëshme(rregullta), ndërsa zbatimin e tyre ua beson organeve që i emëron për të udhëhequr me gara.

II. PJESËMARRËSIT NË GARA

Neni 4

Pjesëmarrësit në gara janë klubet(skuadrat), të cilat duhen të jenë të regjistruara në organet kompetente të komunave si dhe në organet kompetente të Federatës së Hendbollit të Kosovës.

Neni 5

Nëse një klub(skuadër) në një vit garues nuk merrë pjesë në shkallën(rangun) e garave për të cilat është kualifikuar, apo gjatë garave tërhiqet apo përjashtohet, në vitin tjetër garues(kampionatin e ri), automatikisht kalon në rang(shkallë) më të ultë të garave.

Neni 6

Nëse vjen deri të fuzionimi(bashkimi) i dy klubeve, para përfundimit të afateve kalimtare të përcaktuara me Rregullorën e FHK-së mbi regjistrimin e klubeve dhe lojtarëve, klubi i ri e merrë(zënë) vendin në shkallën(rangun) më të lartë të garave, në të cilin ka marrë pjesë njëri prej klubeve të fuzionuara(bashkuara), ndërsa lojtarët e të dy klubeve kanë të drejt të lojës për klubin e ri.

Nëse ky fuzionim është bërë pas afatit kalimtar sipas Rregullorës së FHK-së mbi regjistrimin e klubeve dhe lojtarëve, klubi i ri e merrë(zë) vendin në rangun më të lartë të garave, në të cilin ka marrë pjesë njëri prej klubeve të fuzionuara, ndërsa në lojëra për klubin e ri kanë të drejt të paraqiten vetëm lojtarët e klubit të rangut më të lartë të garave, ndërsa lojtarët e klubit tjetër këtë të drejt e fitojnë vetëm në afatin tjetër kalimtar.

Neni 7

Antarët e SHGJHK-së (gjyqtarët, kontrolluesit) si dhe vëzhguesit nuk mund të kryejnë dy funksione, të jenë edhe gjyqtarë, kontrollues apo vëzhgues në ndeshje dhe njëkohsisht të jenë edhe trajner apo përfaqësues i klubit në ndeshje kampionale.

Antari i SHGJHK-së i cili dëshiron të kryej funksione tjera më pare duhet të jep dorëheqje me shkrim nga SHGJHK-ja për atë kohë të caktuar (vit garues).

Neni 8

Lojtarët të cilët janë aktiv në klube, cilët janë antarë të SHGJHK-së, mund të drejtojnë ndeshjet (gjykojnë) vetëm ndeshjet e rangjeve tjera ku ata nuk marrin pjesë në gara (garojnë).

Neni 9

Sipas grup-moshave lojtarët dhe lojtarët sistemohen sipas kategorive në vijim:

- deri në 12 vjet mini –handballi
- deri në 15 vjet pionerët dhe pioneret
- deri në 17 vjet kadetët dhe kadetet
- deri në 19 vjet juniorët(të rinjtë) dhe junioret(të rejtat)
- deri në 21 vjet të rinjtë (shpresat olimpikët) meshkuj- femra
- mbi 21 vjet të rriturit(seniorët) dhe të rriturat(seniorët).

Në garat kampionale të grup-moshave të reja të drejt garimi kanë të gjithë lojtarët të lindur në vitin kalendarik përkatës, pa marrë parasysh datën dhe muajn e sakt të lindjes.

III. SISTEMI I GARAVE

Neni 10

Sistemi i garave në teritorin e Kosovës përfshinë:

- garat kampionale të seniorëve dhe senioreve
- garat për kupën e Kosovës
- garat kampionale të grup-moshave të reja
- garat kampionale në beach-handball (hendbolli në rërë)

Neni 11

Garat kampionale të seniorëve dhe senioreve përfshijnë:

- Supërliga në konkurrencën e meshkujve
- Ligën e parë dhe të dytë të meshkujve
- Ligën e Parë dhe të dytë në konkurrencën e femrave

Neni 12

Garat e kupës së Kosovës përfshijnë:

- garat e rregullta të klubeve të regjistruara në FHK sipas programit dhe orarit të caktuar me Propozicione të veçanta.

Neni 13

Në garat kampionale të grup-moshave të reja përfshihen:

Kampionatet ekipore të Kosovës për pionerë e pionere, kadetë dhe kadete, juniorë dhe juniore.

Këto gara zhvillohen në formë të turneve dhe organizohen gjatë vikendeve, të cilat i përcakton dhe i organizon FHK-ja.

Pjesëmarrës në garat kampionale të grup-moshave të reja janë skuadrat nga territori i Kosovës që janë të regjistruara në FHK. Numri i ekipeve nuk është i kufizuar, por në parim numri optimal do të ishte më së shumti deri në 10-12 ekipe.

Neni 14

Rangun e garave e përcakton Kuvendi i FHK-së në përputhje me Statutin dhe Rregullorën e punës së Kuvendit dhe zbatohet sipas sistemit vjeshtë – pranverë (në parim prej shtatorit të një viti deri në qershor të vitit tjetër).

Neni 15

Në pjesën përfundimtare të garave të kupës së Kosovës marrin pjesë skuadrat e kualifikuara gjatë garave sipas sistemit të kupës.

Neni 16

Detajet(hollësitë) rreth zbatimit të drejt për drejt të të gjitha garave të përcaktuara me nenin 8 të kësaj Rregulloreje, për çdo garë veç e veç, përcaktohen me Propozicionet që do ti miratojë Bordi i FHK-së apo organit që i përcakton dhe i organizon garat.

Neni 17

Ndryshimet në sistemin e garave, përkatësisht numrin e pjesëmarrësve dhe mënyrën e zbatimit të të gjitha garave të përcaktuara me nenin 8, të kësaj Rregulloreje, duhet të miratohen më së paku 1(një) vit para fillimit të vitit garues, pas të cilit fillon edhe zbatimi, ndërsa këto ndryshime i përcakton Kuvendi i FHK-së për çdo rang të garave.

Propozimet për ndryshimin e sistemit të garave duhet t'i dorëzohen Bordit të FHK-së më së largu deri në fund të marsit të një viti garues, ndërsa Bordi i FHK-së, duhet ti formulojë dhe të organizojë diskutim publik që do të zgjaste deri në fund të qershorit të të njejt vit, që Kuvendi i FHK-së deri në fund të shtatorit sipas të gjitha propozimeve, patjetër duhet të debatojë dhe të marrë vendim përkatës, që do të fillonte të zbatohet(aplikohet) pas përfundimit të vitit garues, i cili fillon me edicionin e ri të garave.

Neni 18

Dy ekipe të të njejtit klub dhe të njejtës gjini nuk mund të marrin pjesë në rang të njejt të garave, përkatësisht ekipa e dytë e një klubi mund të marrë pjesë në rangun e garave, i cili është për një rang më i ultë nga rangun në të cilën garon ekipi i parë.

Dispozitat nga alineja 1, të këtij neni automatikisht përcillen në të gjitha ekipet e një klubi, përkatësisht ekipi i tretë eventual nuk mund të marrë pjesë na rangun e garave të ekipit të dytë dhe kështu me radhë kjo vlen edhe për të gjitha ekipet që ai klub disponon.

IV. GARAT E HENDBOLLIT NË RËRË

Neni 19.

Në garat kampionale të hendbollit në rërë (beach-handball) përfshihen të gjitha ekipet e interesuara, dhe mosha nuk është e kufizuar, kurse numri i ekipeve mund të jetë më së shumti deri në numrin 16.

Këto gara zhvillohen në formë të turneve dhe organizohen gjatë vikendeve, të cilat i përcakton dhe i organizon FHK-ja, gjatë stinorit veror.

Rregullat aplikohen sipas akteve normative të EHF –it dhe IHF-it mbi hendbollin në rërë (beach-handball).

V. KALENDARI I GARAVE

Neni 20

Për garat e përcaktuara nga neni 9, i kësaj Rregulloreje, përcaktohet kalendari i garave.

Për të gjitha garat kampionale dhe të gjitha rangjet e tyre, kalendarin e garave e përcakton Bordi i FHK-së në bashkpunim me organin që udhëheqë me gara(Komision- komesar i garave).

Neni 21

Kalendari i garave përcaktohet, veçanërisht për çdo vit garues dhe më së voni deri në fund të stinorit vijues për stinorin e ardhshëm.

Neni 22

Në kalendarin e garave veç garave kampionale dhe për kupë, do të shënohen(evidentohen) edhe të gjitha garat ndërkombëtare të Përzgjedhjeve dhe klubeve. Pastaj turnetë solemne dhe përkujtimore si dhe manifestimet tjera. Për gjithë aktivitetin e Përzgjedhjeve, duhet të parashihen terminet e nevojshme për përgatitjen e Përzgjedhjeve shtetërore.

Neni 23

Ndryshimet në kalendarin e garave janë të mundshme vetëm në rastet e jashtëzakonshme dhe ky ndryshim duhet të bëhet më së voni 30 ditë para ngjarjes për shkak së cilës është bërë shtyrja apo ndryshimi i kalendarit të garave.

Disa ndeshje, të parapara me kalendarin e garave, me kërkesë të klubit lojtari të cilit i takon, duhet të shtyhen vetëm në këto raste:

- nëse klubi ka dhënë dy e më shumë lojtarë për Perzgjedhjet e Kosovës të të gjitha grup-moshave,
- nëse klubi merrë pjesë në garat zyrtare ndërkombëtare si në njërin nga kupat evropiane.

VI. PROPOZICIONET E GARAVE

Neni 24

Për garat nga neni 8, i kësaj Rregulloreje, përcaktohen dhe miratohen Propozicionet e garave.

Për të gjitha rangjet e garave Propozicionet e garave i harton dhe i miraton Bodi i FHK-së, me propozim të Këshillave profesionale dhe organit që do të udhëheqë me gara.

Neni 25

Me Propozicione të garave përcaktohen të gjitha kushtet e garimit dhe çështjet tjera me rëndësi për zbatimin e tyre dhe ate:

- zbatimi i garave,
- përcaktimi i plasmanit në gara,
- organet për zbatimin e garave,
- palestrat dhe terrenet për gara,
- lojtarët në gara,
- obligimet e organizatorit të garave
- shpenzimet e garave,
- gjyqtarët në gara,
- vëzhguesit dhe kontrollorët në gara dhe
- ankesat dhe kundërvatjet disiplinore në gara.

VII. ZBATIMI I GARAVE

Neni 26

Sistemin dhe mënyrën e zbatimit të garave e përcakton Kuvendi i FHK-së.

Garat mund të zbatohen:

- me sistem të njëfishtë, dyfishtë apo të shumëfishtë të pikëve,
- me sistem të njëfishtëm dyfishtë apo të shumëfishtë të sistemit të kupës dhe
- sistemit të kombinuar – pikë dhe sistemit kupe.

Neni 27

Garat kampionale të Ligave zhvillohet me sistem pikësh, varësisht nga numri i pjesëmarrësve dhe përcaktohet se a do të luhet me sistem pikësh të dyfishtë apo të shumëfishtë, por në çdo rast çdo pjesëmarrës duhet të jetë aq herë mikpritës(nikoqir) sa edhe musafirë.

Nëse garat e ligës përfundojnë me Play-off (garat shtesë) për plasman përfundimtar, apo kualifikime për plotësim të ligës, sistemi i pikëve mund të kombinohet me sistem të njëfishtë apo të shumëfishtë të kupës.

Garat kampionale të grupmohave të reja, kualifikimet e ndryshme dhe të ngjashme, mund të zhvillohen në formë të turneve me sistem të njëfishtë të pikëve, por mund të luhet edhe me kombinim të sistemit të kupës.

Neni 28

Garat për kupën e Kosovës luhet me sistem të njëfishtë apo të dyfishtë të kupës, ndërsa një pjesë e garave përfundimtare për kupë mund të luhet edhe në formë turneu me sistem pikësh.

Me sistem të njëfishtë apo të dyfishtë të kupës mund të luhet kualifikimet e ndryshme, turnetë perkujtimore dhe të ngjashëm.

VIII. PËRCAKTIMI I PLASMANIT NË GARA

Neni 29

Plasmani në gara përcaktohet varësisht nga sistemi i zbatimit të garave, për të cilën merrë Vendim organi që i përcakton Propozicionet e garave.

Neni 30

Nëse garat zhvillohen me sistem pikësh, plasmani përcaktohet në bazë të numrit më të madh të pikëve të fituara, në atë mënyrë që për fitore fiton 2 pikë, për barazim një pikë dhe për humbje 0 pikë.

Në rast kur dy e më shumë pjesëmarrës fitojnë pikë të njejta, për plasman vendos rezultat e ndërsjellta të ekipeve të interesuara.

Detajet(hollësitë) e përcaktimit të plasmani, nëse garat janë zbatuar me sistem pikësh, përcaktohen me Propozicionet e garave.

Neni 31

Nëse garat zhvillohen(zbatohen) me sistem të kupës, atëherë plasmani përcaktohet në bazë fitoreve të realizuara të parapara, në mënyrë çdo ndeshje zhvillohet deri në realizimin e fitores(në rastet e rezultatit baras duhet të zhvillohen vazhdimet apo me ekzekutimit të shtatësheve).

Nëse garat zhvillohet me sistem të dyfishtë të kupës, plasmani do të përcaktohet në bazë të numrit më të madh të pikëve të fituara, e nëse pikët janë të njejta, atëherë duhet të zhvillohet vazhdimi pas ndeshjes së dytë apo me ekzekutimin e shtatësheve.

Detajet(hollësitë) mbi përcaktimin e plasmanit, nëse garat zhvillohen sipas sistemit të kupës, përcaktohen me Propozicione të garave.

IX. ORGANET QË UDHËHEQIN DHE ZBATOJNË GARAT

Neni 32

Organet që do të udhëheqin dhe do t'i zbatojnë garat i cakton Bordi i FHK-së. Veç organit në shkallë të parë të vendosjes duhet të themelohet edhe Organi i shkallës së dytë i vendosjes, ndërkaq organ kompetent për mbrojtjen e ligjshmerisë si mjet i jashtëzakonshëm juridik është Bordi i FHK-së.

Neni 33

Organ i shkallës së parë për zbatimin e garave është Komisari apo Komisioni i garave i përbërë prej 3 – 5 anëtarëve, që i emëron Bordi i FHK-së.

Organ i shkallës së dytë i vendosjes është Këshilli i garave, i cili përbëhet nga 3 – 5 anëtarë dhe të cilin e emëron Bordi i FHK-së.

Të drejtat dhe obligimet e organeve që udhëheqin dhe zbatojnë garat përcaktohen me Propozicione të garave.

Neni 34

Organi i shkallës së parë që udhëheqë dhe zbaton garat është i obliguar të hartojë dhe lëshojë Buletin, të cilin duhet tu dërgohet klubeve, Shoqatës së Gjyqtarëve, Shoqatës së Trajnerëve dhe palëve të interesuara. Buletini e zavendëson aktin e shkruar(Vendimin) për të gjitha vendimet e shkallës së parë, në mënyrë që në te të shkruhen qartë të gjitha elementet nga vendimet në pajtim me Rregullorën disiplinore të FHK-së.

X. PALESTRAT SPORTIVE TË GARAVE

Neni 35

Palestrat për gara duhet ti plotësojnë kushtet e caktuara, të cilat janë të përcaktuara me Rregulloren e lojës së hendbollit dhe të Propozicioneve të garave, me të cilat mundësohet që të gjitha ndeshjet të zhvillohen dhe të përfundojnë në mënyrë të rregullt. Kushtet të theksuara nga al. 1 e këtij neni përcaktohen me Propozicione të garave.

Neni 36

Para fillimit të ndeshjes gjyqtarët janë të obliguar të përcaktojnë se a janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara dhe se a mund të zhvillohet ndeshja, përkatësisht ndeshja e filluar duhet të ndërpritet, pa marrë parasysh që palestra është e regjistruar për gara.

XI. LOJTARËT NË GARA

Neni 37

Në garat zyrtare mund të paraqiten vetëm lojtarët-et, të cilët në mënyrë të rregullt janë të regjistruar dhe licencuar për klubin e tyre.

Neni 38

Të gjithë lojtarët-et duhet ti nënshtrohen kontrollit mjekësor, i cili vlen 6 muaj. Të gjithë lojtarët-et më të rinj-reja se 16 vjet, për paraqitje për skuadrën e seniorëve, duhet patjetër të kenë kontrollën e mjekut specialist dhe lejen e mjekut të mjeksisë sportive për paraqitje, e cila evidentohet në Librezën e garimit.

Neni 39

Klubet duhet që lojtarët-et e tyre ti sigurojnë të shoqëritë e sigurimit të personave, në rast të lëndimeve të tyre në lojë dhe trajning.

Neni 40

Nëse një klub me dy ekipe merrë pjesë në garat e rregullta kampionale, të drejt paraqitje për ekipin e parë kanë të drejt të gjithë lojtarët-et e regjistruar dhe të licencuar të atij klubi.

Në rastin nga al. 1 për ekipin e dytë të drejt paraqitje nuk kanë lojtarët-et, të cilët 5 e më shumë herë kanë qenë të licencuar për paraqitje në rang më të lartë të garave nga rangi në të cilin merrë pjesë ekipi i dytë, pa marrë parasysh për cilin klub kanë qenë të licencuar.

Dispozitat e al. 2 të këtij neni, automatikisht përcillen edhe në ekipet tjera të atij klubi, përkatësisht për asnjë ekip nuk mund të paraqiten lojtarët-et, të cilët 5 e më shumë herë kanë qenë të licencuar për paraqitje në rang më të lartë të garave, nga paraqitja në të cilin merrë pjesë ekipi i caktuar, pa marrë parasysh për cilin klub kanë qenë të licencuar.

XII. OBLIGIMET E ORGANIZATORIT TË GARAVE(NDESHJEVE)

Neni 41

Organizator dhe mikpritës(nikoqir) i garave (ndeshjeve) është klubi, i cili luan në terren të vet, përkatësisht të cilit i është besuar oragnizimi i garave.

Neni 42

Me Propozicionet e garave duhet të përcaktohen të gjitha obligimet e organizatorit, siç janë: rregullimi dhe dekorimi i palestrave apo terrenit për lojë, sigurimi dhe shërbimi i kujdestarisë, numri i mjaftueshëm i policëve, kujdesi për rend në palestër apo terenin për lojë, siguria për musafirë dhe të gjithë personave zyrtarë, sigurimi i procesverbaleve, mjeteve matëse dhe gjithë atyre për zhvillimin normal të garave(ndeshjeve).

XIII. SHPENZIMET E GARAVE

Neni 43

Me Propozicione të garave duhet të përcaktohen të gjitha shpenzimet e garave(ndeshjeve) dhe kush u bartë ato shpenzime.

Neni 44

Në garat kampionale dhe të ligave shpenzimet e zbatimit dhe zhvillimit të garave dhe organeve që udhëheqin dhe zbatojnë garat janë shpenzime(kotizime) të përbashkëta të të gjitha klubeve, të cilat i përcakton Bordi i FHK-së për çdo vit garues dhe për secilin stinor veç e veç. Ndërsa shpenzimet e disa ndeshjeve të caktuara shpenzimet i bartin barabartë si nikoqiri si musafiri.

Neni 45

Në sistemin e garave në formë të turneve në parim nikoqiri i bartë shpenzimet teknike të organizimit të turneut, ndërsa musafiri të gjitha shpenzimet e veta.

Neni 46

Nëse një klub nuk i ka paguar shpenzimet(kotizimin) e përbashkëta të pjesëmarrjes në gara dhe nëse vërtetohet se nuk ka mundësi ti paguajë apo nuk dëshiron ti paguajë, do të çregjistrohet(largohet) nga garat dhe në vitin tjetër garues automatikisht kalon në rang më të ultë të garave.

Neni 47

Shpenzimet e të gjithë personave zyrtarë në ndeshje (meditja, taksa dhe shpenzimet e udhëtimit), i bartë klubi nikoqir dhe organizatori u garave edhe ate me para të gatshme në bazë të deftesës apo Urëdhëresës, sipas tarifës që e cakton Bordi i FHK-së për secilin rang të garave.

Taksat e rangut më të ultë të garave nuk mund të jenë më të larta se 70% nga lartësia e taksës nga rangu më i lartë i garave.

XIV. GJYQTARËT NË GARA

Neni 48

Për garat e caktuara nga neni 8, i kësaj Rregulloreje, përcaktohet edhe lista e gjyqtarëve.

Neni 49

Listat e gjyqtarëve në të gjitha rangjet e garave i vërteton dhe i miraton Bordi i FHK-së me propozim të Shoqatës së Gjyqtarëve të Hendbollit të Kosovës, të cilat më herët i dërgojnë Tubimet e Lidhjeve Komunale të Hendbollit.

Neni 50

Gjyqtarët të cilët nuk janë në Listat e Lidhjeve Komunale të Hendbollit nuk mund të hyjnë në Listat për miratim nga Bordi i FHK-së.

Neni 51

Në listën e gjyqtarëve në rangun e caktuar të garave mund të futen më së shumti aq qifte të gjyqtarëve sa ka edhe klub pjesëmarrëse në atë rang të garave.

Një qift i gjyqtarëve mund të gjendet(gjykojë) më së shumti në dy rangje të garave.

Neni 52

Gjyqtari, i cili ka mbushur 50 vjet të jetës së tij, nuk mund të gjendet në listën e gjyqtarëve në rangun përkatës të garave, por mund të gjykojë deri në fund të stinorit garues, në të cilin i ka mbushur 50 vjet.

Statusi i gjyqtarit me moshë 50 vjeçare do të rregullohet me kriteret për përpilimin e listave të gjyqtarëve.

Neni 53

Te përcaktimi i listës së gjyqtarëve të rangut të caktuar të garave, duhet patjetër të sigurohet ndryshimet e gjyqtarëve dhe ate që nga lista, nëse në te ka më shumë qifte të

gjqtarëve të paraparë me nenin 49- të al. 1 kësaj Rregulloreje, do të largohen dy qiftet më të pasuksesshme nga viti i kaluar garues, e në listë të futen numri adekuat i qifetve më të suksesshme të gjyqtarëve nga rangu më i ultë i garave.

Neni 54

Çdo klub ka të drejt të kërkojë përjashtimin e qiftit të caktuar të gjyqtarëve për një vit garues.

Një klub ka të drejt të kërkojë përjashtimin e më së shumti dy qifetve të gjyqtarëve.

Qifti i gjyqtarëve përjashtimin e të cilëve e kërkon më së paku 2/3(dy e treta) e klubeve , për atë vit garues nuk mund të jenë në listën e gjyqtarëve.

Kërkesa për përjashtim të ndonjë qifti të gjyqtarëve duhet ti dërgohet Komisarit të garave, apo Komisarit (Komisioni) për çështje të gjyqtarëve para përpilimit të listës së gjyqtarëve dhe ajo duhet të jetë mirë e argumentuar dhe me arsyetim të plotë. Komisari (Komisioni) i garave e vlerëson arsyeshmerinë e kësaj kërkesë dhe me mendim të vet ia dërgon Bordit të FHK-së, sipas së cilës edhe merrë Vendim përkatës.

Neni 55

Propozimin për delegimin e gjyqtarëve për ndeshjet e caktuara e bën Komisari(Komisioni) për çështje të gjyqtarëve, të cilin ja përcjellë Komisarit (Komisionit) të garave i cili ka të drejtë ndryshimi të propozimit nga Komisari (Komisioni) për delegim.

Neni 56

Nëse në ndeshje nuk vjen ndonjëri nga gjyqtarët e deleguar, ndeshjen do ta drejtoj gjyqtari tjetër i deleguar.

Nëse vjen njëri nga gjyqtarët me vonesë në lojë, ai nuk mund të inkuadrohet pas fillimit të ndeshjes, por ndeshjen do e gjykojë ai gjyqtar i cili ka filluar ndeshjen nga fillimi.

Nëse në ndeshje nuk vjen asnjëri nga gjyqtarët e deleguar, ndeshjen do ta drejtojnë gjyqtarët nga lista e përcaktuar nëse ndodhën në palestër(teren), ndërsa kjo do të bëhet me marrëveshtjen e klubeve dhe nëse klubet nuk mund të mirren vesh atëherë për këtë vendos vëzhguesi(kontrolluesi).

Nëse në ndeshje nuk vjen qifti i deleguar dhe në palestër nuk ka gjyqtarë përkatës, vëzhguesi është i obliguar që të krijoj mundësi që ndeshja të zhvillohet më vonë në të njëjtën ditë, apo në ditën e nesërme dhe për terminin e caktuar të i sigurojë gjyqtarët e deleguar apo gjyqtarët nga lista e përcaktuar.

XV. VËZHGUESIT DHE KONTROLLUESIT NË NDESHJE

Neni 57

Për garat e cekuar në nenin 8, të kësaj Rregulloreje, përcaktohet lista e vëzhguesve dhe kontrolluesve.

Neni 58

Listën e vëzhguesve dhe kontrolluesve e përcakton Bordi i FHK-së dhe ate:

- vëzhguesit me propozim të Komisarit(Komisionit) të garave,
- kontrolluesve me propozim të Shoqatës së Gjyqtarëve të Hendbollit të Kosovës, të cilët më pare i kanë propozuar Tubimet e gjyqtarëve të Lidhjeve Komunale të Hendbollit.

Neni 59

Lista e vëzhguesve dhe kontrolluesve të rangut të caktuar të garave është unike dhe ne të mund të gjenden aq vëzhgues dhe kontrollor sa ka edhe klube në atë rang të garave.

Një vëzhgues apo kontrollues mund të gjendet vetëm në dy rangje të garave.

Neni 60

Vëzhguesi apo kontrolluesi, i cili i ka mbushur 65 vjet të jetës së tij, nuk mund të jetë më në listën e vëzhguesve apo kontrolluesve, ndërsa detyrën do të kryjë deri në fund të stinorit garues kur dhe i ka mnushur 65 vjet.

Statusi i vëzhguesve-kontrolluesit që i kanë mbushur mbi 65 vjet, do të rregullohet me kriteret për përpilimin e listave për vëzhgues e kontrollues.

Neni 61

Me rastin e përcaktimit të listës për vëzhgues dhe kontrollues në rangun e caktuar të garave duhet patjetër të sigurohet ndryshimi i tyre dhe ate që nga lista, nëse ka numër të madh të vëzhguesve dhe kontrollorve të paraparë me nenin 59 të kësaj Rregulloreje, do të largohen më së paku dy vëzhgues apo kontrollues dhe në listë të vihen numër përkatës i vëzhguesve apo kontrolluesve nga rangu më i ultë i garave.

Neni 62

Çdo klub ka të drejt të kërkojë përjashtimin e vëzhguesit apo kontrolluesit të caktuar për një vit garues.

Një klub ka të drejt të kërkojë përjashtimin e më së shumti dy vëzhguesve apo kontrolluesve.

Vëzhguesi apo kontrolluesi përjashtimin e të cilit e kërkon më së paku 2/3 (dy e treta) e klubeve , për atë vit garues nuk mund të jenë në listën e vëzhguesve apo kontrolluesve. Kërkesa për përjashtim të ndonjë vëzhguesi apo kontrolluesi duhet ti dërgohet Komisarit (Komisioni) të garave, apo Komisarit (Komisionit) për çështje të gjyqtarëve para përpilimit të listës për vëzhgues dhe kontrollues dhe ajo duhet të jetë mirë e argumentuar dhe me arsyetim të plotë. Komisari(Komisioni) i garave e vlerëson arsyeshmerinë e kësaj kërkesë

dhe me mendim të vet ia dërgon Bordit të FHK-së, sipas së cilës edhe merrë Vendim përkatës.

Neni 63

Delegimin e vëzhguesve e bën Komisari(Komisioni) i Garave, sipas propozimit të Komisarit (Komisionit) për çështje të gjyqtarëve, por me të drejtë ndrrimi në rastet e caktuara.

Neni 64

Vëzhguesi përkatësisht kontrolluesi në ndeshje është përfaqësues i Organit, i cili udhëheqë(zbaton) garat dhe detyra e tij është që të bëjë mbikqyrje komplete mbi organizimin e ndeshjes, gjithënjë në përputhje me këtë Rregullore, Propozicionet e garave dhe rregullave të lojës.

Organi që udhëheqë(zbaton) me gara është i obliguar që të hartojë dhe miratojë udhëzimin mbi të drejtat dhe obligimet e vëzhguesit përkatësisht kontrolluesit.

Neni 65

Kontrolluesi në ndeshje, për çështje të gjyqtarëve, kryen edhe kontrollën dhe vlerësimin e gjykimit, në pikëpamje të zbatimit(aplikimit) të rregullave të lojës, në bazë të së cilës në fund të vitit garues përcaktohet rang – lista e gjyqtarëve, dhe më këtë rast bënë edhe notimin e gjyqtarëve.

Neni 66

Nëse në ndeshje nuk vjen vëzhguesi apo kontrolluesi më parë i caktuar(deleguar), këtë detyrë do ta kryejë vëzhguesi apo kontrolluesi që gjendet në listë nëse ai gjendet në palestër apo terren, sipas marrëveshtjes së klubeve.

Nëse në palestër apo terren nuk ndodhet (ka) vëzhgues apo kontrollues nga lista e përcaktuar apo nuk arrihet marrëveshtje të klubeve, këtë detyrë e merrë gjyqtari i parë, apo njëri prej gjyqtarëve të deleguar.

Neni 67

Të gjitha klubet e FHK-së janë të obliguara që të kenë trajner të licencuar dhe të kualifikuar për rangun e garave në të cilën bëjnë pjesë, në të kundërt nuk mund të udhëheqin me ekip.

Neni 68

Në rangun më të lartë të garave në Superligë, trajner mund të jenë vetëm ata të cilët disponojnë me licencën "A" dhe 'B' sipas kriterëve të Rregullores së Shoqatës së Trajnerëve të Hendbollit të Kosovës.

Neni 69

Trajner i licencuar i cili mund të udhëheqë klubet e Ligave të para, mund të jenë ata trajner që disponojnë kualifikimin për trajner me licencë 'B' dhe 'C', të cilat janë conform Rregullores mbi Licencim të SHTHK-së.

Neni 70

Kurse trajner të klubet e Ligës së dytë dhe kategoritë e grupmoshave të reja (pionier, kadet dhe junior) mund të jenë dhe të udhëheqin trajnerët së paku me licencën "D" dhe "E" por nën përkujdesjen e mentorit i cili do të mbikqyrë punën e tyre.

Neni 71

Klubet të cilat nuk kanë trajner me licencë përkatëse, mund të sigurojnë licencën e përkohshme e cila lëshohet nga SHTHK-ja, për një periudhë të caktuar kohore, duke paguar në arkën e SHTHK-së një shumë të caktuar materjale e cila do të shkojë në fondin e Shoqatës mbi përparimin dhe licencimin e kuadrove.

Neni 72

Klubet dhe trajnerët janë të obliguar të kenë kontratat e punës sipas akteve normative të klubit dhe ligjit mbi punësim, kontratë kjo e cila vertetohet edhe në SHTHK-së gjegjësisht në FHK-së.

Trajneri si mjet ligjor për realizimin e përmbushjës së kontratës duhet t'u drejtohet Gjykatës Komunale e cila është kompetente të marr vendim në bazë të akteve ligjore.

XVII. ANKESAT DHE KUNDËRVAJTJET DISIPLINORE NË GARA

Neni 73

Në ndeshjen e zhvilluar, çdo klub ka të drejt ankese. Ankesa paralajmërohet para se të nënshkruhet procesverbali, e më së voni në afat prej 30 minutave pas përfundimit të ndeshjes.

Ankesa në regjstrim dhe të drejtën e paraqitjes së lojtarit, kushtet e lojës në palestër apo terren dhe kushtet tjera për lojë, patjetër duhet të paralajmërohet para fillimit të ndeshjes, në të kundërtën ankesa nuk do të mirrret në shqyrtim.

Paralajmërimi i ankesës automatikisht nënkupton edhe pagesën e taksës, lartësia e së cilës përcaktohet me Propozicione të garave.

Arsyetimi i ankesës duhet të dërgohet në afat prej 48 orëve pas përfundimit të takimit dhe në të njëjtin afat do të paguhet edhe pjesa tjetër e taksës e përcaktuar me Propozicione të garave.

Neni 74

Organi i shkallës së parë që udhëheqë me gara, vendos në shkallë të parë në afat prej 7-15 ditë nga dita e pranimit të ankesës, ndërsa ky afat vetëm në raste të jashtëzakonshme mund të jetë më i gjatë.

Në Vendimet e oragnit nga al. 1 e këtij neni është e lejuar ankesa në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimit të vendimit, Organit të shkallës së dytë.

Neni 75

Organ i shkallës së dytë është Këshilli i garave, i cili vendos sipas ankesave ndaj Vendimeve të Organit të shkallës së parë. Afati i vendosjes sipas ankesës është 15 ditë nga dita e pranimit të saj.

Vendimet e oragnit nga al.1 e këtij neni janë përfundimtare në procedurën admnistrative. Pala e pakënaqur mund të ushtrojë kërkesë për mbrojtjen e ligjëshmerisë Bordit të FHK-së.

Neni 76

Duke vendosur sipas ankesës, Organi i shkallës së dytë mund të:

- ankesën ta refuzojë dhe të vërtetojë vendimin e Org. të shkallës së parë,
- ankesën ta miratojë dhe vendimin e Org. të shkallës së parë të anulojë dhe lëndën të ja kthejë në rishqyrtim dhe vendosje dhe
- ankesën ta miratojë dhe vendimin e Org. të shkallës së parë të anulojë tërsisht.

Neni 77

Nëse në Vendimin e Organit të shkallës së parë ankohet klubi, i cili ka parashtruar ankesë edhe në organin e shkallës së parë, i njëjti lirohet nga pagesa e taksës, ndërsa nëse në

Vendim ankohet pala tjetër, parashtruesi i ankesës është i obliguar të paguajë taksën sipas Propozicioneve të garave.

Neni 78

Në garat shtesë(Play-off), për kupë dhe në rastet e ngjajshme, kur terminet e ndeshjeve këtë e kërkojnë, të gjitha afatet për parashtrim të ankesave si dhe për marrjen e vendimeve në shkallë të parë dhe të dytë, zvoglohen në përputhje me terminet e zhvillimit të ndeshjeve të radhës dhe kjo veçanërisht rregullohet me Propozicione të garave.

Neni 79

Sipas ankesës së parashtruar ndeshja do të regjistrohet me rezultat zyrtar 10:0 në të mirë të parashtruesit në këto raste.

- nëse për skuadrën rivale ka luajtur lojtari, i cili pavarësisht mbi cilën bazë nuk ka pasur të drejt paraqitje(loje),
- nëse skuadra është paraqitur edhe pse ka qenë nën dënim apo pezullim(suspendim) nga oragni komptent.

Përfundim nga dispozitat e al. 1 pika 1 e këtij neni, do të bëhet dhe do të mirret Vendim mbi anulimin e ndeshjes dhe të zhvillimit të ndeshjes së re, nëse konstatohet që skuadra nuk ka pasur njohuri apo nuk ka pasë mundësi të di, që lojtari nuk ka pasur të drejt loje.

Neni 80

Sipas ankesës ndeshja do të anulohet dhe do të caktohet zhvillimi i ndeshjes së re në këto raste:

- nëse ndeshja është zhvilluar në palestër, e cila nuk i plotëson kushtet për lojë sipas Propozicioneve të garave.
- nëse gjyqtarët kanë bërë shkelje të rregullave të lojës, të cilat kanë ndikuar në rezultat përfundimtar të ndeshjes.

Neni 81

Ndeshja në të cilën nuk ka pasur ankesa në afat nuk mund të anulohet.

Neni 82

E gjithë procedura disiplinore sipas kundërvajtjeve në lidhje me ndeshjen, udhëheqen dhe zhvillohen si dhe dënimet mirren në përputhje me dispozitat e Rregullorës disiplinore të FHK-së dhe Propozicionve te garave.

Neni 83

Në nivel të FHK-së oragnet kompetente që zhvillojnë procedurën disiplinore janë:

- Organ i shkallës së parë për zhvillimin e procedurës dhe i vendosjes është Organi që udhëheqë(zbaton) garat,
- Organi i shkallës së dytë është Këshilli i garave
- Komisioni disiplinor që zhvillon procedurën dhe merr vendime për kundërvajtjet jashtë zhvillimit të garave dhe ndaj personave drejtues dhe të punësuarit në FHK.
Për kundërvajtjet që bëjnë gjyqtarët, organ i shkallës së parë është Komisioni(Komisioni) për çështje të gjyqtarëve, ndërsa organ i shkallës së dytë disiplinor është Këshilli i garave.

Neni 84

Të gjitha dënimet(ndëshkimet) që u shqiptohen, klubeve, drejtuesve(funksionarvëe) të klubeve, lojtarëve dhe personave zyrtarë të shqiptuara gjatë një viti garues, nëse ato nuk janë mbajtur dhe përmbushur, ato do të mbahen në vitin tjetër(vijues) garues, pa marrë parasyshë nëse klubi e ka ndërruar rangun e garave apo lojtari e ka ndërruar klubin.

Neni 85

Të gjitha Vendimet, ankesat dhe kundërvajtjet disiplinore të Organit të shkallës së dytë janë përfundimtare, ndërsa mjet i jashtëzakonshëm juridik është Kërkesa për mbrojtjen e Rregulloreve dhe përsëritje të procedurës.

Neni 86

Kërkesa për mbrojtjen e Rregulloreve dhe kërkesa për përsëritje të procedurës mund të parashtrihen në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të Vendimit të Organit të shkallës së dytë.

Neni 87

- Kërkesa për mbrojtjen e Rregulloreve mund të parashtrihet në këto raste:
- nëse Organi i shkallës së parë përkatësisht të dytë, gjatë vendosjes nuk ka pasur kourum,
 - nëse Organi i shkallës së parë përkatësisht të dytë ka qenë i themeluar nga persona që nuk janë anëtarë të tyre,
 - nëse gjatë marrjes së Vendimit të Org. të shkallës së parë apo të dytë ka marrë pjesë anëtari që nuk ka pasur të drejt vendosje,
 - nëse ka ardhur deri te aplikimi i gabuar i dispozitave të kësaj Rregulloreje, Propozicioneve të garave, Rregullorës disiplinore dhe rregulloreve tjera të FHK-së.

Neni 88

Organ për mbrojtjen e Rregulloreve dhe të ligjëshmërisë është Bordi i FHK-së.

Neni 89

Kërkesa për përsëritje të procedurës i dërgohet Organit, i cili ka marrë marrë vendim në shkallë të parë dhe ai është kompetent për të vendosur.

Kërkesa për përsëritje të procedurës mund të ushtrohet pas marrjës së Vendimeve të shkallës së parë apo të dytë, nëse ka ardhur deri të faktet e reja të cilat do të ishin me rëndësi dhe ndikim për marrjen e Vendimit dhe ndryshimit të tij.

Neni 90

Organi kompetent kërkesën për përsëritje të procedurës, mund ta miratojë, të marrë Vendim të ri, të refuzojë si i palejuar, i ushtruar jashtë afatit apo ta refuzojë si të pabazë.

Neni 91

Kërkesa për mbrojtjen e Rregulloreve dhe për përsëritje të procedurës, nuk e ndalon ekzekutimin(përmbushjen) e Vendimit të plotfuqishëm , me përjashtim në rastet kur me ekzekutimin e tij do të shkaktohej dëm i pakompenzueshëm.

Në rastin nga al. 1 e këtij neni, Vendmimin për mosekzekutim të Vendimit të plotfuqishëm me procedurë të shpejtë e merrë(bjen) kryetari i Bordit të FHK-së.

XVIII. ORGANIZIMI DHE ZHVILLIMI I NDESHJES

Neni 92

Organizimin e ndeshjes e zbaton klubi mikpritës(nikoqir) dhe ate në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje, Propozicione të garave dhe akteve tjera dhe është i obligueshëm të sigurojë të gjitha kushtet për lojë normale.

Neni 93

Ndeshja do të ndërpritet përkohësisht në këto raste:

- nëse për shkak të fuqisë madhore vjen deri të zvoglimi i shikushmërisë, që vazhdimi i lojës është i pamundshëm(ndalja e rrymës dhe ngjajshëm). Në këtë rast ndeshja do të vazhdojë kur të pushojnë pengesat për çka është ndërprerë, ndërsa nëse pengesat nuk mund të menjanohen atë ditë, ndeshja do të zhvillohet(vazhdohet) ditën e nesërme.
- Nëse për shkak të fuqisë madhore vije deri të ndryshimi i madh i temperaturës, kështu që vazhdimi i lojës është i pamundshëm, në këtë rast vazhdimi o ndeshjes do të bëhet kur këto pengesa do të pushojnë dhe nëse këto pengesa nuk menjanohen, ndeshja do të zhvillohet ditën e nesërme,

- nëse ndeshja është dobët e oragnizuar dhe vjen deri të hudhja e gjësendeve në terren. Në këtë rast vëzhguesi dhe gjyqtari do të kërkojnë nga organizatori që të vëhët rend dhe rregull apo edhe të kërkojnë zbrazen e palestrës apo një pjesë të saj, ndërsa pas kësaj ndeshja do të vazhdojë.
Nëse ndeshja e ndërprerë përkohësisht nag al. 1 e 2 të këtij neni, nuk mund të vazhdohet në të njejtën ditë por as ditën e nesërme, përkatësisht në rastin nga al. 3 të këtij neni, në afat prej 60 minutave ndeshja do të ndërpritet përfundimisht dhe nuk do të zhvillohet.

Neni 94

Ndeshja do të ndërpritet deri në fund në këto raste:

- nëse vjen deri të sulmi fizik i gjyqtarëve apo vëzhguesit nga ana e shikuesve, lojtarëve apo personave zyrtarë,
- nëse vjen deri të sulmi fizik ndaj lojtarëve, personave zyrtarë të klubeve apo gjyqtarëve dhe vëzhguesit nga ana e shikuesve,
- nëse vjen deri të qërimi i hesapeve (përleshja) ndërmjet lojtarëve apo personave zyrtar të klubeve dhe për këtë shkak sipas vlerësimit të gjyqtarëve, nuk është i mundshëm vazhdimi i lojës,
- nëse vjen deri të situata ku sipas Rregullave të lojës është paraparë ndërprerja përfundimisht(deri në fund) e ndeshjes.

Neni 95

Ndeshja do të regjistrohet me rezultat zyrtar (10:0) në të mirë të skuadrës rivale(kundërshtare), pa marrë parasyshtë nëse në këtë është ushtruar ankesa në këto raste:

- nëse skuadra ndodhet nën pezullim(suspendim) apo dënim të shqiptuar nga organet kompetente,
- nëse skuadra nuk e ka zhvilluar ndeshjen dhe për këtë nuk ka pasur shkaqe të arsyeshme,
- nëse skuadra e lëshon terrenin dhe refuzon të vazhdojë lojën e filluar,
- nëse skuadra refuzon që ndeshjen ta gjykojnë gjyqtarët e deleguar, apo në rastin e mos ardhjes së tyre, të gjyqtarëve të caktuar dhe të përcaktuar sipas Propozicioneve të garave,
- nëse tereni nuk ka qenë i përgatitur(aftësuar) për lojë me fajin e mikpritësit përkatësisht të organizatorit të ndeshjes,
- nëse me fajin e ndonjerës prej skuadrave vjen deri të ndërprerja e ndeshjes deri në fund, ndërsa nëse konstatohet se për ndërprerje të ndeshjes deri në fund nuk është fajtor asnjëra nga skuadrat, përkatësisht nëse për këtë ndërprerje janë fajtor të dyja skuadrat në mënyrë të përbashkët, do të caktohet termin ri për zhvillim të ri të ndeshjes.

Në rastet e cekuar në al. 1 të këtij neni, përveq që ndeshja do të regjistrohet me rezultat zyrtar, kundër klubit dhe personave zyrtarë të klubit mund të hapet procedura disiplinore sipas Rregullorës disiplinore të FHK-së.

Neni 96

Ndeshja duhet të fillojë sakt në kohën dhe terminin e caktuar, që përcaktohet me orën e vëzhguesit.

Koha e pritjes e një skuadre është 30 minuta, por që vëzhguesi ka të drejt që këtë kohë të vazhdojë më së shumti deri në 60 minuta, nëse një gjë të tillë e lejojnë kushtet dhe shfrytëzimi i palestrës për lojë.

Nëse skuadra ka paralajmëruar vonesën, ndërsa vëzhguesi vlerëson se për këtë ka arsye, vëzhguesi ka për detyrë ti hulumtojë të gjitha mundsitë dhe të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme organizative me qëllim që ndeshja të zhvillohet në të njejtën ditë apo ditën e nesërme.

XIX. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 97

Udhëzimin për aplikimin e kësaj Rregulloreje dhe komentimit të saj e bën Bordi i FHK-së.

Neni 98

Propozicionet e garave dhe të gjitha aktet tjera në lidhje me garat, të cilat nuk janë në përputhje me këtë Rregullore, duhet që harmonizhen më së largu deri në fund të vitit garues në të cilin është miratuar kjo Rregullore.

Neni 99

Kjo Rregullore hynë në fuqi dhe do të aplikohet 8(tetë) ditë nga dita e miratimit nga ana e Bordit të FHK-së.

**Prishtinë,
1.03.2004.**

**Kryetari
Mexhit Devaja**
